



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 747 Prot.

Tiranë, më 19.05.2021

VENDIM QARKULLUES

Nr. 91, datë 19.05.2021

“PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË KOMISIONIT TË KURRIKULAVE”

Në zbatim të neneve 38 (pika 1, gërma “i”), 46 (pika 3) të Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL e RSH”, të neneve 20 (gërma “n”), 26 të Statutit të UST-së në nenin 10 pika 6 të Rregullores së UST-së, Senati Akademik me Vendim Qarkullues,

VENDOSI

1. Miratimin e Rregullores së Komisionit të Kurrikulave.
2. Bashkëlidhur këtij vendimi qarkullues gjendet rregullorja e miratuar, e cila më pas i përcillet Komisionit për zbatim.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

PROF.DR. AGRON KASA



PROF.DR. ADRIATIK META

PROF.DR. AGRON CUKA

PROF.DR. DHURATA BOZO

PROF.DR. FATOS GJATA

PROF.ASOC. ARBEN KAÇURRI

PROF.ASOC. ROBERT ÇITOZI

PROF.ASOC. JUEL JARANI

PROF.ASOC. FERDINAND MARA

PROF.ASOC. BASHKIM DELIA

DR. ELTON SPAHIU

XHEMAL ÇULLHAJ

AMBER URSI



Rregullore e Organizimit të Veprimtarisë së Komisionit për Kurrikulat



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS

**RREGULLORE E ORGANIZIMIT TË VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT PËR
KURRIKULAT**

Neni 1

Objekti

Kjo rregullore përcakton organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Përhershëm në nivel institucioni për Kurrikulat në Universitetin e Sporteve të Tiranës, si dhe bashkërendon marrëdhëniet e këtij Komisioni me sektorin e kurrikulës dhe me organet e autoritetet drejtuese si dhe me të gjitha strukturat e UST-së .

Neni 2

Baza Ligjore

Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Përhershëm për Kurrikulat mbështetet në Ligjin nr. 80/2015 datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në Statutin e Universitetit të Sporteve të Tiranës, Rregulloren e Universitetit, Vendimin e Senatit Akademik të UST-së nr.86, datë 14.05.2021, si dhe të gjitha aktet e tjera ligjore në fuqi.

Neni 3

Komisioni për Kurrikulat

1. Komisioni për Kurrikulat është organ kolegjal vendimarrës dhe këshillimor që ngrihet pranë universitetit nga Senati Akademik për organizimin dhe drejtimin e studimeve sipas Statutit të UST-së.



Rregullore e Organizimit të Veprimtarisë së Komisionit për Kurrikulat

2. Komisioni për Kurrikulat ka në përbërje të tij 5 (pesë) anëtarë, ku 4 (katër) anëtarët e këtij komisioni, të cilët janë staf akademik zgjidhen nga Senati Akademik mbi bazë të vetë kandidimit të Personelit Akademik. Anëtari i pestë është student, dhe zgjidhet nga Këshilli Studentor. Anëtarët e këtij Komisioni zgjidhen për një mandat 2 (dy) vjeçar, me të drejtë rizgjedhje.
3. Komisioni kontrollon veprimtarinë e Njesisë së Kurrikulave, mbi bazën e një raportimi periodik 6 mujor nga kjo e fundit.
4. Mandati i anëtarëve të komisionit përfundon kur:
 - Për stafin:
 1. Jep dorëheqjen;
 2. Largohet nga puna;
 3. Ka mospërputhje me detyrat e tjera që mund të marrë ;
 4. Merr vërejtje të rëndë nga komisioni ad hoc;
 5. Mungon 2 (dy) mbledhje rradhazi pa arsye.
 - Për studentin:
 1. Jep dorëheqjen;
 2. Përfundon statusi i tij si student;
 3. Mungon 2 (dy) mbledhje rradhazi pa arsye.

Neni 4 Zgjedhja e kryetarit

Kryetari i Komisionit për Kurrikulat zgjidhet me votim në Senatin Akademik dhe në mbledhjen e tij të parë të konstituimit, Kryetari i Senatit e prezanton përpara anëtarëve të tjerë të komisionit. Ai do të jetë drejtuesi i tij për periudhën e mandatit të këtij Komisioni, sipas përcaktimit të pikës 2, të nenit 1.

Neni 5 Vendimarrja në Komision



Mbledhjet e Komisionit quhen të vlefshme, në rast se në të marrin pjesë më shumë se gjysma e të gjithë anëtarëve. Vendimet merren me 50% + 1 votë të anëtarëve pjesëmarrës në mbledhje. Në rast barazimi, vota e kryetarit të mbledhjes është vendimtare.

Neni 6

Afatet e mbledhjes së Komisionit

- Komisioni mblidhet në mbledhje të zakonshme të paktën një herë në 2 (dy) muaj për periudhën 10 (dhjetë) mujore.
- Në raste të nevojshme, kryetari mund të thërrasë mbledhjen e jashtëzakonshme dhe është ai që nënshkruan aktet që miraton komisioni.
- Për çështje të caktuara, ai kërkon që në mbledhjet e Komisionit pa të drejtë vote të marrin pjesë edhe përfaqësues të organeve drejtuese të Institucionit, dhe/ose edhe persona të tjerë nga stafi akademik.
- Në çdo rast lajmërimet për thirrjen e mbledhjeve, rendi i ditës së bashku me dokumentacionin shoqëruar, bëhen nëpërmjet postës zyrtare elektronike të institucionit, të paktën 2 (dy) ditë përpara datës së thirrjes së mbledhjes si dhe njoftimeve nëpërmjet telefonit.
- Raporti vjetor i komisionit quhet i miratuar kur është votuar me shumicë të cilësuar të anëtarëve.
- Proces-verbali i komisionit mbahet nga sekretari i komisionit dhe firmoset nga të gjithë anëtarët pjesëmarrës në mbledhje.
- Sekretari ruan bllokun e proces-verbaleve si dhe të gjithë dokumentacionin që ka lidhje me komisionin.

Neni 7

Fusha e veprimtarisë së Komisionit



1. Komisioni për Kurrikulat përcakton drejtimit kryesore, në lidhje me fizionominë e Institucionin për natyrën e programeve të studimit që ai duhet të ofrojë.
2. Komisioni për Kurrikulat është përgjegjës për përcaktimin e politikave orientuese në drejtim të hapjes së programeve të reja të studimit, si dhe të përmirësimit të atyre ekzistuese në përputhje me Standartet Shtetërorë të Cilësisë në Arsimin e Lartë, dhe atyre të Hapësirës Europiane të Arsimin të Lartë (HEAL).
3. Komisioni për Kurrikulat , i propozon Senatit akademik, pasi ka marrë edhe mendimin e Njesisë së Kurrikulave, nevojën e ndryshimeve në kurrikula dhe programe studimeve, në përputhje me nevojat e tregut të punës.
4. Komisioni për Kurrikulat , në raste të caktuara kur e shikon të arsyeshme, mund të zhvillojë edhe mbledhje të përbashkëta me Komisione të tjera për nevojat e Institucionit, në drejtim të përcaktimit të politikave orientuese për hapjen e programeve të reja, rifreskimit të atyre ekzistuese, si dhe çështje të tjera të natyrës mësimore dhe akademike.

Neni 8

Hyrja në fuqi e Rregullores

Kjo Rregullore hyn në fuqi, pasi miratohet nga Senati Akademik.